

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 17 MARS 2022

Zonja Kryetare,

Në disa kërkesa të njëpasnjëshme që ne bëjmë, i referohem një kërkesë që unë kam bërë për pyetje me ministrin e Brendshëm dhe një nisme ligjore, që ka të bëjë me çmimin e naftës, dua t'ju sjell në vëmendje se Rregullorja vërtet është në krahun tuaj lidhur me shqyrtimin dhe zgjatjen e tyre në kohë, por ne kemi qenë prezentë në këtë sallë, ku, për nevoja që qeveria i ka quajtur gjithmonë urgjente, sipas saj, parlamenti ka ecur shumë shpejt me miratime aktesh të caktuara.

Nuk besoj se ekskluzivitetin e përcaktimit të një urgjence e ka vetëm qeveria, sepse kjo do t'i deformonte krejtësisht edhe funksionin e këtij parlamenti, edhe detyrat që ka. Nismat përkatëse kanë të gjitha elementet e urgjencës, sepse nuk besoj se ka ndonjë në këtë sallë që të thotë se çështja e çmimeve, në mënyrë të veçanta ajo e çmimeve të karburanteve, nuk është një emergjencë, dhe, së dyti, shqetësimet që kishin lidhje me pyetjet për ministrin e Brendshëm, kishin të bënin me elemente që lidhen me protestat që kanë ndodhur, ku janë paralajmëruar se do të ndodhin edhe të tjera, siç jemi njohur. Të dyja do të na ndihmonin në këtë drejtim, qoftë edhe debati për to dhe eventualiteti i të qenit pozitiv nga ana e maxhorancës do të ishte një lajm i mirë, pavarësisht se nuk do të ndodhte. Kështu që do t'ju lutesha t'i shikonit me një sy tjetër, sepse nuk mund të ketë dy emergjenca.

Pra, emergjencë është ajo që përcakton qeveria dhe nuk është emergjencë ajo për të cilën opozita merr një nismë të caktuar. Ndaj, unë kërkoj që ju ta përdorni autoritetin tuaj që të zhdërvjelltësohen, sepse strategjia, tashmë shumë e njohur, e të bërit sikur po zbatoni procedurën, por duke e zgjatur dhe zvarritur në kohë, duke i humbur aktualitetin dhe njëherazi duke i hapur rrugë qeverisë që të veprojnë si të dojë nuk është në të mirën e qytetarëve, jo thjesht një e mirë ose e keqe e opozitës. Kështu që, në rast se ju e keni këtë predispozitë, do të ishte mirë ta demonstroit, në të kundërt do të ishte shumë qesharake që ne të flisnim në këtë sallë, duke thënë se qeveria ka këtë urgjencë dhe i do këto akte dhe këto ligje me nxitim të madh.

Ju lutem, merreni në konsideratë!